



Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.


Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimin e punonjësve të institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit mars, 2026

Ekipi Tematik Teknik Antikorrupsion dakordëson raportin e monitorimit të zbatimit të SNKK për vitin 2025

26.03.2026: Ekipi Tematik Teknik Antikorrupsion miratoi Raportin Vjetor të Monitorimit për vitin 2025, për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030. Ky raport paraqet një pasqyrë të progresit të arritur në zbatimin e masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit, nivelin e realizimit të treguesve të performancës, si dhe sfidat e hasura gjatë periudhës së raportimit. Për vitin 2025, strategjia ka shënuar një nivel të përgjithshëm zbatimi prej 83.5%. Nga 47 masa dhe 138 aktivitete të planifikuara, janë realizuar 24 masa dhe 91 aktivitete, 16 masa dhe 20 aktivitete mbetur në proces, ndërsa 7 masa dhe 27 aktivitete nuk janë realizuar. Politika parandaluese ka arritur një nivel realizimi prej 90%, politika ndëshkuese 73.1% dhe politika e ndërgjegjësimit 87.5%, duke reflektuar progres të qëndrueshëm në të tre drejtimet kryesore. Miratimi i paketës ligjore “Antikorrupsion”, forcimi i instrumenteve të integritetit dhe aplikimi i metodologjive për vlerësimin e riskut dhe identifikimin e hapësirave për korrupsion, si dhe përpjekjet për rritjen e efektivitetit të hetimit dhe ndjekjes penale përmes bashkëpunimit ndërinstytucional dhe rritjes së kapaciteteve, kanë qenë ndër zhvillimet kryesore. Ndërgjegjësimi dhe edukimi antikorrupsion kanë vijuar përmes zgjerimit të aktiviteteve edukative dhe komunikimit publik, duke rritur përfshirjen e qytetarëve, veçanërisht të të rinjve.



DPAK nis procesin e vlerësimit të riskut të korrupsionit në sektorët e pronave, tatimeve dhe doganave

30.03.2026: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit përgatit nisjen e procesit të vlerësimit të riskut të korrupsionit në sektorët e pronave, administratës tatimore dhe sistemit doganor, përmes një takimi pune me Koordinatorët Kundër Korrupsionit pranë institucioneve përgjegjëse. Ky proces zhvillohet në kuadër të zbatimit të Objektivit Specifik 1.3 të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, me synim forcimin e qasjeve parandaluese në sektorët me risk të lartë. Vlerësimi do të realizohet në përputhje me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në sektorin publik, përmes ngritjes së grupeve të punës me përfaqësues të institucioneve përkatëse dhe Koordinatorët Kundër Korrupsionit, nën drejtimin dhe koordinimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit. Procesi mbështetet nga asistencë teknike e projektit EU4GG dhe synon identifikimin e risqeve, analizimin e proceseve dhe hartimin e masave parandaluese, duke kontribuar në forcimin e integritetit dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve në këta sektorë. Procesi do të vijojë me mbledhjen dhe analizimin e të dhënave nga institucionet përkatëse, si dhe me zhvillimin e vlerësimeve të detajuara për secilin sektor. Rezultatet e këtij procesi do të shërbejnë si bazë për hartimin e masave konkrete dhe planeve të veprimit për menaxhimin e risqeve të identifikuara.



Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit procedon 8 masa disiplinore

1-31.03.2026: Aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në fushën e hetimit dhe verifikimit administrativ ka vijuar me verifikimin e rasteve (ankesa e denoncime) të marra nga qytetarët. Gjatë muajit mars 2026, është përfunduar 1 Raport Përfundimtar për Drejtorinë Vendore të ASHK-së Fier dhe janë propozuar 8 masa disiplinore. Në këtë kontekst, nëpërmjet këtij raporti janë dhënë 5 rekomandime të cilat në 3 raste adresojnë çështje të natyrës administrative dhe lidhen me procedura konkrete, dhe në 2 raste adresojnë çështje me natyrë organizative si në lidhje me menaxhimin e përditshëm dhe procedurat e brendshme të institucionit. Gjithashtu, nisur nga roli i rëndësishëm i DPAK për sa i përket parandalimit të korrupsionit, këto rekomandime bazohen në parimet e përmirësimit të qëndrueshëm të institucionit, kapaciteteve menaxhuese, ligjore, dhe teknike në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Nëpërmjet rekomandimeve synohet ndikimi konkret në përmirësimin e problematikave sistematike, të cilat lidhen me qartësimin e praktikave të brendshme, standardizimit të procedurave në lidhje me aspektet administrative dhe organizative, forcimit të bashkëpunimit ndërinstytucional, si dhe rritjes së llogaridhënies.



Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit merr pjesë në takimin e Nënkomitetit BE-Shqipëri, për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë

3-4.03.2026: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit iu bashkua delegacionit shtetëror në Bruksel, duke marrë pjesë në raportimet zyrtare në kuadër të takimit të 17-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian–Shqipëri për “Drejtesinë, Lirinë dhe Sigurinë”. Në këtë platformë dialogu ndërmjet institucioneve shqiptare dhe shërbimeve të Komisionit Evropian, u vlerësua progresi i arritur dhe prioritetet në fushën e parandalimit të korrupsionit në kuadër të procesit të integritetit. Mekanizma të integritetit, të transparencës dhe llogaridhënies në institucionet publike, progresi i kuadrit strategjik, kuadri rregullator dhe institucional në fushën e sinjalizimit, rregullimit të lobimit, menaxhimit të konfliktit të interesit, si dhe baza e kuadrit të ri ligjor për donacionet dhe sponsorizimet ishin disa prej pikave për diskutim. Gjithashtu, u evidentua progresi i arritur në drejtim të konsolidimit të kuadrit institucional, përmes forcimit të strukturave përgjegjëse dhe rritjes së kapaciteteve administrative. Në tërësi, zhvillimet e prezantuara përbëjnë hapa të rëndësishëm drejt përbushjes së piketave të ndërmjetme në kuadër të Kapitullit 23, duke reflektuar angazhimin e vazhdueshëm të institucioneve shqiptare për të avancuar standardet e sundimit të ligjit dhe për të forcuar besimin e publikut.



Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit i bashkohet iniciativës së Këshillit të Evropës për forcimin e integritetit në pushtetin vendor

10-13.03.2026 : Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit iu bashkua iniciativës së zyrës së Këshillit të Evropës dhe të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, në kuadër të projektit “*Forcimi i qëndrueshmërisë së sektorit publik kundër korrupsionit*”, në organizimin dhe lehtësimin e seminareve në rrethet Korçë, Tiranë, Vlorë dhe Shkodër me stafet e strukturave antikorrupsion pr 61 bashkitë e vendit. Zhvillimet e reja dhe praktikat më të mira në parandalimin e korrupsionit, masat e integritetit dhe standardet evropiane për zbatimin mekanizmave antikorrupsion. Ekspertë të Këshillit të Evropës prezantuan për punonjësit e bashkive mekanizmin i GRECO-s dhe rolin e tij për shtetet anëtare, praktikat më të mira evropiane në parandalimin e korrupsionit në nivel lokal, si dhe zhvillimet më të fundit në kuadrin ligjor dhe politikat antikorrupsion. Gjithashtu, u trajtuan elemente kyçe si kuadri institucional për integritetin, mekanizmat e transparencës, mbrojtja e sinjalizuesve dhe mësimet e nxjerra nga praktikat evropiane. Në fokus të veçantë ishte edhe fillimi i përgatitjes së autoriteteve publike për raundi i gjashtë të vlerësimit në GRECO, si konkretisht metodologjia dhe temat kryesore për vlerësim referuar autoriteteve të pushtetit vendor.



Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit zhvillon konsultime e shoqërinë civile për Planin e Veprimit të OGP, 2026-2030

5 & 17.03.2026: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit po kryen procesin e bashkë-krijimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisjen e Hapur (OGP) 2026-2030, për komponentin “Lufta kundër korrupsionit”. Përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese me organizata të shoqërisë civile, aktive në fushën e antikorrupsionit dhe të qeverisjes së mirë, u zhvilluan dy takime konsultimi për konceptimin e masave dhe të produkteve të pritshme me impakt forcimin e integritetit në administratën publike. Anëtarë të Komitetit Shumëpalësh të OGP u bashkuan gjithashtu takimit. Takimi i parë (5.3.2026) u fokusua në mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve nga organizatat e shoqërisë civile, mbi bazën e kontributeve të tyre në fazën fillestare të konsultimit, me synim zhvillimin e masave dhe aktiviteteve konkrete për Planin e Veprimit. Në takimin e dytë (17.3.2026) u prezantuan rezultatet e kësaj faze, draft-angazhimet konkrete të propozuara. Në përfundim, u dakordësua konsolidimi i angazhimeve në një numër masash, me qëllim rritjen e qartësisë, fokusit dhe zbatueshmërisë së Planit të Veprimit. Drafti i Planit Kombëtar të Veprimit për OGP, 2026-2030, për komponentin “Lufta kundër korrupsionit”, është dërguar për konsultim përfundimtar pranë organizatave të shoqërisë civile në datë 30.03.2026, në rrugë elektronike, me qëllim finalizimin e tij dhe dërgimin e draftit final për shqyrtim në Komitetin Shumëpalësh gjatë muajit prill.

Integrimi gjinor dhe mekanizmat e integritetit në fokus të bashkëpunimit institucional

10.03.2026: Promovimi i barazisë gjinore dhe forcimi i mekanizmave të integritetit mbeten prioritetet kyçe për ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme, transparente dhe gjithëpërfshirëse. Këto çështje ishin në fokus të një tryeze të përbashkët të organizuar nën koordinimin e Ministrat të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsion, nga Drejtoria e Përgjithshme të Antikorrupsionit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe UN Women Albania. Aktiviteti shërbeu si një platformë për shkëmbimin e praktikave më të mira dhe forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional dhe me partnerët ndërkombëtarë. Në këtë kuadër u prezantua “Udhëzuesi për Integrimin Gjinor në Masat Kundër Korrupsionit”, i hartuar në kuadër të një projekti të mbështetur nga Bashkimi Evropian, i cili synon të mbështesë institucionet publike në integrimin sistematik të perspektivës gjinore në politikat dhe masat antikorrupsion. Diskutimet u përqendruan në rëndësinë e përfshirjes së perspektivës gjinore në hartimin dhe zbatimin e politikave publike, si dhe në forcimin e mekanizmave të integritetit. Një vëmendje e veçantë iu kushtua rolit të grave në parandalimin dhe adresimin e korrupsionit, duke theksuar kontributin e tyre në promovimin e transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet e qeverisjes. Kjo qasje kontribuon në zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe në përmbushjen e detyrimeve në kuadër të procesit të integritetit evropian, duke afruar më tej Shqipërinë me standardet dhe praktikatat më të mira të Bashkimit Evropian.

